



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI I KOMUNËS KOMITETI PËR KOMUNITETE

EKSTRAKT

nga procesverbali i mbajtur më 16 shkurt 2017, në mbledhjen e XXXIII (tridhjetetë) të Komitetit për Komunitete.

Mbledhja u mbajt në sallën nr. 31 dhe filloi në orën 11.10'.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z. Shaban Ahmeti, kryesues i këtij Komiteti.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e këtij Komiteti dhe atë: Shaban Osmani, Bahri Selimi, Radisav Perović, Xhafer Adem dhe Mefail Rama, ndërsa mungoi Xhevdet Beselica.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe Liman Zeqiri, shef i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, Fadil Babatinca, Policia e Kosovës, Bashkim Bajrami, Policia Kufitare, Muharrem Haziri, OSBE, Kovacsh, përfaqësues i LMT – KFOR.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i propozuar i ditës u miratua njëzëri.

2. Shqyrtimi i mundësive për ofrimin e ndihmës financiare (Miratimin e rekomandimit) për organizimin e festës së flamurit të komunitetit rom.

Kryesuesi z. Shaban Ahmeti, theksoi, në mbledhjen paraprake e kemi shqyrtuar mundësinë për sigurimin e mjeteve financiare për mbështetje financiare për organizimin e manifestimit më 15 shkurtit, ditës nacionale - Flamurit të ashkalive, në atë mbledhje e kam theksuar se Kryetari i Komunës më ka premtuar se do të bëjë zgjidhje për këtë çështje dhe shtoi, do të angazhohem që të sigurohen mjetet financiare në mënyrë që edhe komuniteti rom të organizoj dhe kremtoj festën e tyre.

z. Mefail Rama, theksoi, dita e komunitetit rom në Komunën e Podujevës nuk është festuar që nga paslufta e këndej, andaj do të ishim shumë mirënjohës nëse sigurohet një shumë e caktuar e mjeteve financiare për organizimin e festës së flamurit rom që është data 8 prill.

Unë, pas kësaj mbledhjeje, në emër të komunitetit rom do të bëjë kërkesë për mbështetje financiare për organizimin e kësaj feste.

z. Liman Zeqiri, theksoi, konsideroj se do të ishte mirë që të sigurohen mjetet në mënyrë që edhe komuniteti rom të organizoj manifestimin për ditën e flamurit të tyre.

Zotëriu Mefail Rama, tha se do të bënë kërkesë për sigurimin e mjeteve financiare për këtë manifestim, sugjerimi im është që kërkesa t'i adresohet Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, kuptohet me të dhënat

e nevojshme përkatësisht numrin e pjesëmarrësve që do të ftohen, a do të organizohet drekë apo koktej dhe afërsisht kostoja e shpenzimeve.

Në cilësinë e shefit të Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, do të angazhohem që kjo kërkesë të realizohet.

3. Vizitë e komuniteteve pakicë në rrugën “Xhafer Meta” në Podujevë.

Kryesuesi z. Shaban Ahmeti, e paraqiti fjalën hyrëse.

Pas propozimeve dhe votimit, njëzëri u ngrit Grupi punues për vizitë familjet në rrugën “ Xhafer Meta “ në Podujevë, në këtë përbërje:

1. Shaban Ahmeti, kryesues
2. Shaban Osmani, anëtar dhe
3. Xhafer Ademi, anëtar

Grupi punues pas vizitës do të hartoj raportin përkatës i cili do të shqyrtohet në mbledhjen e radhës të këtij Komiteti.

z. Liman Zeqiri, theksoi, unë në cilësinë e shefit të Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim thuajse çdo ditë kam kontakte me pjesëtarët e komunitete e RAE dhe jam mjaftë mirë i informuar për gjendjen e tyre, për këtë ju kam informuar qoftë përmes raporteve apo kur janë trajtuar çështje të ndryshme, mirëpo pavarësisht kësaj e përshëndes ngritjen e këtij Grupi punues për vizitë komunitetin ashkali në rrugën “ Xhafer Meta “ në Podujevë, në mënyrë që nga ana e këtij Komiteti të bisedohet drejtpërdrejt me qytetarët përkatës dhe të informohet për problemet dhe brengat me të cilat përballet ai komunitet.

Unë jam i hapur dhe kam gatishmëri të plotë që t'i bashkëngjitem këtij grupi gjatë vizitës në atë lagje dhe sipas nevojës do të ofroj informacione të nevojshme.

4. Të ndryshme

Kryesuesi z. Shaban Ahmeti, i ftoi anëtarët e këtij Komiteti dhe pjesëmarrësit tjerë në këtë mbledhje që të marrin pjesëmarrje në manifestimin ditës nacionale - Flamurit të ashkalive.

0

Mbledhja përfundoi në orën 11.30’.

Procesverbalin e mbajti

Faik Gashi

Nr. 01-060/04-13787/17

Podujevë,

16 shkurt 2017

Kryesuesi i Komitetit

Shaban Ahmeti